

Gjykata Supreme e Kosovës
API-KŽI. Nr. 2/2011
Prishtinë
25 maj 2012

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, ka mbajtur seancën e kolegjit në pajtim me nenin 26 paragrafin (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së), dhe nenin 15.4 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Lmk-së) më 25 maj 2012 në ndërtesën e Gjykatës Supreme, në kolegjin e përbërë nga:

Gjyqtari i EULEX Tore Thomassen si kryetar i kolegjit,
Gjyqtari i EULEX-it Martti Harsia, Gjyqtari i EULEX-it Dr. Horst Proetel, Gjyqtari i Gjykatës Supreme Nebojša Boričić dhe Gjyqtarja e Gjykatës Supreme Gyltene Sylejmani si anëtarë të kolegjit,

me Zyrtarin ligjor të EULEX-it Holger Engelmann si procesmbajtës,
në prani të

Avokatit mbrojtës [redacted] për të pandehurin [redacted] HB

LXhM

Në çështjen penale me numër API.-KŽI. Nr. 2/2011 kundër të pandehurit:

HB

[redacted]
në paraburgim prej 10 majit 2006.

I shpallur fajtor në shkallë të parë me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P. Nr. 605/2008, të datës 4 gusht 2010, për

1. Vrasje të rëndë në shkelje të nenit 147 paragrafit 1 pikës 11 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së) dhe
2. Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në shkelje të nenit 328 paragrafit 2 të KPK-së.

I dënuar me dënim unik afatgjatë prej njëzetedy (22) viteve burgim, me kohën e kaluar në paraburgim të llogaritur si pjesë e dënimit;

Më 20 prill 2011, Gjykata Supreme e Kosovës në kolegjin e apelit të përbërë nga pesë (5) Gjyqtarë të Kosovës të Gjykatës Supreme me anë të aktgjyimit AP.-KŽ. Nr. 10/2011 ka pranuar ankesat e Prokurorit Publik dhe palës së dëmtuar dhe ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P. Nr. 605/2008, të datës 4 gusht 2010, në lidhje me dënimin, dënimin e të pandehurit me dënim unik prej njëzetepesë (25) viteve burgim afatgjatë, kurse ka refuzuar ankesën e mbrojtjes si të pabazuar.



XhM

HB

Më 4 korrik 2011, Avokati mbrojtës [redacted] në emër të [redacted] ka paraqitur ankesë brenda afatit kohor kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës (ZPSH-së), me përgjigjen e datës 18 korrik 2011 të regjistruar në shkrimoren e Gjykatës Supreme të Kosovës në të njëjtën ditë, plotësisht ka kundërshtuar të gjitha aspektet e ankesës si të pabazuara dhe prandaj ka propozuar që ankesa refuzohet dhe aktgjykimi i kontestuar të vërtetohet.

Duke vendosur në lidhje me ankesën e avokatit mbrojtës [redacted] të paraqitur në emër të pandehurit më 4 korrik 2011 kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës AP.-KŽ. Nr. 10/2010, të datës 20 prill 2011 dhe në bazë të aktgjykimit me shkrim P. Nr. 605/2008 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P. Nr. 605/2008, të datës 4 gusht 2010, duke pasur parasysh përgjigjen e ZPSHK-së të paraqitur më 18 korrik 2011, të dhënat dhe dokumentet përkatëse dhe parashtresat verbale të palëve gjatë seancës më 25 maj 2012, së bashku me analizën e ligjit të aplikueshëm, Gjykata Supreme e Kosovës, pas këshillimit në të njëjtën ditë, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

HB

Ankesa e paraqitur nga avokati mbrojtës në emër të pandehurit [redacted] më 4 korrik 2011 kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës AP.-KŽ. Nr. 10/2011, të datës 20 prill 2011, **REFUZOHET SI E PABAZUAR**. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës AP.-KŽ. Nr. 10/2011, i datës 20 prill 2011, **VËRTETOHET**.

ARSYETIM

I. Historia e procedurës

AL'

DL

Më 10 tetor 2005, në fshatin Babimoc (Komuna e Obiliqit) vëllezërit [redacted] dhe [redacted] janë qëlluar për vdekje.

I pandehuri [redacted] është arrestuar më 10 maj 2006 pasi që ishte dorëzuar vullnetarisht.

Më 3 gusht 2006, Prokurori Publik i Qarkut në Prishtinë ka ngritur aktakuzën PP. Nr. 770-1/2005 kundër të pandehurit [redacted] duke e akuzuar atë për **Vrasje të rëndë të shlytëzimit të paautorizuar të armëve**.

Aktakuza është konfirmuar me aktvendimin KA. 578/06, më 2 tetor 2006.

Shqyrtimi i parë gjyqësor ka filluar më 12 janar 2007 para trupit gjykues të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të përbërë nga 2 gjyqtarë profesional dhe 3 gjyqtarë porotë. Pas 5 seancave më 22 korrik 2007 trupi gjykues i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë ka shpallur të pandehurin fajtor për dy pika të Vrasjes sipas nenit 146 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK-së), të dënueshme si **Vrasje e rëndë** sipas nenit 147 paragrafit 1 pikës 11 të KPPK-së dhe **Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328 par. 2 të KPPK-së** dhe e ka dënuar me burgim afatgjatë prej njëzetedy (22) viteve.

Më 27 gusht 2008, pas ankesave të paraqitura nga mbrojtja dhe prokurori, Gjykata Supreme e Kosovës ka anuluar aktgjykimin e shkallës së parë dhe e ka kthyer çështjen në rigjykim.

SB Me vendimin e 3 korrikut 2009, duke vepruar në lidhje me kërkesën e avokatit mbrojtës të paraqitur më 29 janar 2009, Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it ia ka caktuar çështjen e rigjykimit gjyqtarëve të EULEX-it në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

Rigjykimi para kolegjit të përbërë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtar i Kosovës i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë ka filluar më 3 dhjetor 2009 dhe ka vazhduar me 11 seanca (më 3, 10 dhe 14 dhjetor 2009, 10 shkurt, 31 mars, 8 dhe 23 prill, 21 maj, 15 qershor, 3 dhe 4 gusht 2010).

AT Gjykata ka dëgjuar dëshmitë e dëshmitarëve në vijim: **RH** **BG¹** **BG²** **RrL** **AL²** **BO**
HB ekspertëve Dr. [redacted] dhe [redacted] si dhe ka ekzaminuar të pandehurin dhe ka bërë rikonstrukcionin e vendit të ngjarjes në të cilin viktimat janë privuar nga jeta. **TG** **HK**

Përveç kësaj, gjykata e shkallës së parë ka vendosur që të administroj një numër të provave dokumentare, në mesin e tyre raportet e vendit të krimit dhe forenzikës të paraqitur nga Policia e Kosovës më 14, 15 dhe 21 tetor 2005, ekspertizën forenzike dhe balistike të datës 1 qershor 2007, raportin plotësues të balistikës të datës 16 dhjetor 2009, ekzaminimin *post mortem* të viktimave [redacted] dhe [redacted] të datës 30 tetor dhe 10 nëntor 2005, kontratën e blerjes së pronës së paluajtsime në mes [redacted] it si shitës dhe [redacted] si blerës të lidhur më 20 shtator 2005 në Gjykatën Komunale në Prishtinë, deklaratat e disa dëshmitarëve të regjistruara në vitet 2005 dhe 2006 dhe procesverbalin e shqyrtimit të parë gjyqësor. **DL²** **BL**

AL¹ Aktakuza së fundmi është ndryshuar gojarisht gjatë seancës së 3 gushtit 2010 për të përfshirë fjalët: "...pas një fjalosjeje të çastit në mes të pandehurit dhe tani dy të ndjerëve dhe [redacted] dhe [redacted]..." **AL²**

AL¹ Në bazë të provave të mbledhura, gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike dhe më 4 gusht 2010 ka shpallur aktgjykimin, duke e shpallur të pandehurin fajtor për **Vrasje të rëndë** të [redacted] dhe [redacted] dhe **Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve**. Gjykata e Qarkut ka dënuar të pandehurin me dënim unik prej njëzetedy (22) viteve burgim afatgjatë. **DL¹**



Aktgjykimi është apeluar brenda afatit të përcaktuar nga Prokurori i Qarkut në Prishtinë, përfaqësuesi i palës së dëmtuar avokati Gazmend Nushi dhe avokati mbrojtës i të pandehurit Xhafer Maliqi.

Më 20 prill 2011, Gjykata Supreme e Kosovës në kolegjin e apelit të përbërë nga 5 gjyqtarë të Kosovës të Gjykatës Supreme me aktgjykimin AP.-KŽ. Nt. 10/2011 ka pranuar ankesat e Prokurorit Publik dhe palës së dëmtuar dhe ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P. Nr. 605/2008, të datës 4 gusht 2010 në lidhje me dënimin, duke e dënuar të pandehurin me dënim unik prej njëzetepesë (25) vite burgim afatgjatë, kurse ka refuzuar ankesën e avokatit mbrojtës si të pabazuar.

Aktgjykimi i është dorëzuar të pandehurit më 22 qershor 2011.

Më 4 korrik 2011, avokati mbrojtës [REDACTED] në emër të [REDACTED] brenda afatit të përcaktuar ka paraqitur ankesë kundër aktgjykimin të gjykatës së shkallës së dytë.

ZPSHK-ja me përgjigjen e datës 18 korrik 2011 të regjistruar në shkrimoren e Gjykatës Supreme të Kosovës në të njëjtën ditë, plotësisht ka kundërshtuar të gjitha aspektet e ankesës ti të pabazuara dhe prandaj ka propozuar që ankesa të refuzohet dhe aktgjykimi i kontestuar të vërtetohet.

II. Parashtresat e palëve

1. Ankesa

I pandehuri më 4 korrik 2011, brenda afatit të përcaktuar ka paraqitur ankesë kundër aktgjykimin të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 20 prill 2011 (Ap.-Kz. Nr. 10/2011). Është pretenduar se aktgjykimi përmban shkelje esenciale të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal dhe se sanksionimi penal i shqiptuar është i padrejtë. I pandehuri propozon që të aprovohet ankesa dhe të anulohet ose ndryshohet aktgjykimin.

Ai, në veçanti kundërshton se Gjykata Supreme ka dështuar që të eliminojë kundërthëniet, mospërputhjet dhe paqartësitë ekzistuese në aktgjykimin e shkallës së parë në lidhje me veprimet e viktimave kundër të pandehurit para dhe gjatë shtënave vdekjeprurëse dhe në lidhje me motivin e të pandehurit për të ndërmarrë veprimet inkriminuese.

Dispozitivi i aktgjykimin të Gjykatës së Qarkut është kundërthënës në brendinë e tij kur gjen se i pandehuri "...me vetë dëshirë pas një zënke të çastit kishte vvarë [REDACTED] dhe [REDACTED]", dhe në anën tjetër gjetja në disa rreshta më tutje se i pandehuri pas mosmarrëveshjes verbale ishte "... tërhequr zvarrë nga viktimat nga ara në rrugën dytësore."

Fakti se fjala "tërhequr zvarrë", e cila mungon në versionin në gjuhën shqipe të dispozitivit të gjykatës së shkallës së parë, gabimisht është cilësuar si gabim teknik nga Gjykata Supreme. Po të kishte ndodhur vërtet ashtu, gjykata do të duhej ta korrigjonte atë me aktvendim të veçantë.

Aktgjykimi i kontestuar ka bërë shkelje të ligjit penal pasi ka dështuar që ta zbatojë nenin 8 paragrafin 2 të KPK-së. I pandehuri gjatë të shtënave në viktimat kishte reaguuar ndaj sulmit të kundërligjshëm, real të atëçastshëm nga tre vëllezërit [redacted] [L]

Si alternativë, nëse nuk konstatohet se ekzistojnë rrethanat e mbrojtjes së nevojshme, Gjykata e Apelit është dashur të marrë parasysh dispozitën e nenit 8 paragrafin 3 të KPK-së dhe të cilësojë veprimin e të pandehurit si tejkalim i kufijve të mbrojtjes së nevojshme [L]

Gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të saktë, në mënyrë specifike në lidhje me legjitimitetit të shfrytëzimit të tokës nga familja [redacted] çështjen nëse ka ekzistuar kërcënimi i jetës apo ndonjë sulm mbi të pandehurin nga tre vëllezërit [redacted] dhe nëse veprimet e ndërmarra nga i pandehuri kanë qenë për tu mbrojtur nga një sulm i tillë. [L]

Gjithashtu, ai pohon se Gjykata Supreme ka dështuar që të shqyrtojë të gjitha faktet dhe rrethanat relevante për llogaritjen e dënimit, siç është përcaktuar me nenin 64 të KPK-së. Dënimi nuk është në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe me intensitetin dhe rrezikun shoqëror të veprës penale. Në veçanti, formulimi "...mënyra mizore në të cilën është kryer vepra penale" nuk është mbështetur nga gjetjet e gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e Apelit është dashur të zbatojë dispozitën e nenit 8 paragrafët 3 dhe 4 të KPK-së dhe të zvogëlojë apo ta lirojë nga dënimi.

2. Përgjigja e ZPSHK-së [HB]


Me përgjigjen e datës 18 korrik 2011 të regjistruar në Shkrimoren e Gjykatës Supreme të Kosovës po të njëjtën ditë, ZPSHK-ja në tërësi i kundërshton të gjitha aspektet e ankesës si të pabazuara dhe prandaj propozon që ankesa të refuzohet dhe aktgjykimi i kundërshtuar lidhur me [redacted] të vërtetohet.

ZPSHK-ja, në veçanti pohon se avokati mbrojtës padrejtësisht pretendon në ankesë se gjendja faktike nuk ishte vërtetuar drejt dhe plotësisht. Ky pretendim është pa përmbajtje. Gjykata e shkallës së parë plotësisht i ka vërtetuar të gjitha faktet e domosdoshme për vlerësimin e përgjegjësisë penale të të pandehurit. Gjykata nuk gjeti prova se viktimat e ndjera kishin sulmuar drejtpërdrejt jetën e të pandehurit apo se kishin planifikuar ta sulmonin viktimën. Nuk mund të vërtetohet as pretendimi i të pandehurit se e kishin kanosur apo sulmuar me kaçavidë. Policia nuk ka gjetur një vegël të tillë gjatë kontrollimit të vendit të gjuajtës me armë dhe veturës së viktimës.

Dispozitivët e aktgjykimeve të kundërshtuara janë të qarta, të kuptueshme dhe pa kundërthënie. Nuk përmbajnë shkelje të ligjit penal dhe dënimet e shqiptuara janë në përputhje me përgjegjësinë e vërtetuar penale të të akuzuarit dhe të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese janë marrë parasysh.

III. Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Ankesa është paraqitur me kohë dhe është e pranueshme por e pabazuar



1. Shkeljet substanciale të dispozitave të Procedurës Penale

Në përputhje me nenin 430 paragrafin 2 lidhur me nenin 415 paragrafin 1 të KPPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës është dashur t'i shqyrtojë aktgjykimet e apeluara sipas detyrës zyrtare në lidhje me shkeljet e renditura aty.

Kolegji vërteton se Gjykata Supreme në shkallë të dytë kishte kompetencë lëndore dhe ishte në përbërje të duhur. Nuk është shkelur asnjëra nga dispozitat e përmendura, me përjashtim të dispozitës së nenit 403 paragrafit 1 pikës 12 të KPPK-së, për të cilën do të diskutohet më poshtë.

Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se dispozitivi i aktgjyimit të apeluar është i qartë, i kuptueshëm dhe pa asnjë kundërthënie ose mospërputhje të brendshme apo kundërthënie ose mospërputhje me bazat e aktgjyimit.

Ankesa thjesht përsërit argumentet që ishin parashtruar në ankesën kundër aktgjyimit të shkallës së parë dhe të cilat tanimë është diskutuar dhe që Gjykata Supreme i ka refuzuar me aktgjykimin e kundërshtuar.

Kolegji pajtohet plotësisht me arsyetimin e aktgjyimit të kundërshtuar në faqen 3, paragrafin 4 (të versionit në gjuhën angleze), ku Gjykata Supreme shtjellon se kundërthëniet e pretenduara të cilat mbrojtja i kundërshton janë vetëm variacione shprehimore pa dallime në kuptim dhe se ato përbëjnë kundërthënie.

Gjykata vëren se fjalët “zënkë” dhe “mosmarrëveshje verbale” kanë kuptim të njëjtë dhe mund të përdoren si sinonime. Nuk ka kundërthënie lidhur me koordinimin e këtyre dy formulimeve. Dy herë është pohuar se veprimet inkriminuese të të pandehurit kanë ndodhur pas mosmarrëveshjes/zënkës me vëllezërit. Fakti që i pandehuri ishte tërhequr zvarrë nga viktimat është vetëm një shtesë e informatës së dhënë në pjesën e parë të dispozitivit. Kjo nuk mund assesi të interpretohet si kundërthënie.

Sa i përket fjalës “tërhequr” që mungonte në versionin në gjuhën shqipe të dispozitivit të aktgjyimit të shkallës së parë, Gjykata Supreme drejt e ka cilësuar si gabim të vogël teknik. Nuk kishte nevojë për aktvendim të veçantë korrigjues pasi që gabimi është deklaruar dhe është korrigjuar me aktgjykimin e shkallës së dytë.

2. Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike

I pandehuri kundërshton se vërtetimi i gjendjes faktike është bërë në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë.

Gjykata vështron se barra e provës për rrethanën shfajësuese të mbrojtjes së nevojshme në të cilën pretendon i pandehuri i takon atij. Mirëpo, nuk është paraqitur asnjë provë e besueshme për sulm të vazhdueshëm apo të atëçastshëm në momentin kur i pandehuri ka shtënë në drejtim të viktimës.

Nuk është relevante nëse tërheqja e të pandehurit nga fusha nga vëllezërit do të interpretohet si sulm, pasi që nuk kontestohet që ky veprim ishte kryer dhe më nuk ishte i atëçastshëm në kohën për të cilën bëhet fjalë.

Nuk ekziston asnjë provë në mbështetje të pretendimit të të pandehurit se viktimat ishin kthyer pas zënkës së parë, e as për pretendimin se njëri nga vëllezërit kishte marrë një kaçavidë apo një mjet të ngjashëm nga vetura, të cilin donte ta përdorte për sulm. Pretendimi i të pandehurit në lidhje me këtë është kundërshtuar dhe asnjë provë nuk është gjetur më mbështetje të këtij pretendimi.

Po ashtu gjetjet balistike e kundërshtojnë këtë pohim mjaft. Viktimat janë qëlluar prej një largësie prej 6 deri 7 metra. Janë shkrepur së paku 3 të shtëna dhe ka shumë gjasa që ishin drejtuar ka viktimat e jo në ajër si gjuajtje paralajmëruese.

Nuk ka asnjë provë as për tejkalim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme, që do të qonte deri te zbutja e dënimit apo te hejja dorë nga dënimi. Të dy aktgjykimet e kundërshtuara kanë shtjelluar saktë dhe hollësisht çështjen dhe kanë ardhur deri te përfundimi i drejtë.

Aktgjykimi i kundërshtuar në pajtim me gjetjet e Gjykatës së Qarkut gjatë shqyrtimit gjyqësor konstaton saktë se nuk është çështje e diskutueshme se familja [REDACTED] ishin duke e shfrytëzuar fushën në bazë të marrëveshjes për qira me pronarin paraprak [REDACTED]. Kështu ishte puna deri kur toka në pyetje i është shitur kushëririt të të pandehurit [REDACTED] 20 shtator 2005.

Pretendimet e të pandehurit se familja [REDACTED] faktikisht e kishte uzurpuar tokën, duke e penguar shitjen e saj, dhe se viktimat e ndjera e kishin kanosur dëshmitarin [REDACTED] që to mos e blinin tokën në pyetje nuk janë vërtetuar e as nuk janë relevante. Këto janë vetëm pretendime të pavërtetuara të të pandehurit, që nuk janë të mbështetura me asnjë provë. Nuk janë relevante për vlerësimin e përgjegjësisë penale të të pandehurit pasi që është e pakontestueshme se toka ishte shitur [REDACTED] në datën e lartpërmendur, i cili ia kishte lëshuar të pandehurit për ta punuar.


Motivi i të pandehurit është vërtetuar në mënyre specifike dhe konsekuente me të gjitha gjetjet e tjera faktike se veprimet e tij ishin të shtyra nga poshtërimi dhe zemërimi se ishte tërhequr zvarrë me forcë nga ara derisa ishte duke lëruar.

3. Shkelja e ligjit penal

Kolegji gjen se gjykata e shkallës së parë si dhe Gjykata e Apelit e kanë gabim kur vlerësojnë nëse jeta e të pandehurit ishte sulmuar. Kjo nuk është relevante për çështjen se a ka ekzistuar situata e mbrojtjes së nevojshme. I mjaftueshëm është sulmi i atëçastshëm në vlerën apo të drejtën e mbrojtur me ligj. Çështja se ndaj kujt ishte drejtuar sulmi, p.sh. trupit apo jetës, etj., bëhet relevante vetëm për proporcionalitetin e veprimit mbrojtës. Një person që vepron në mbrojtje të nevojshme ka të drejtën e përdorimit të forcës vdekjeprurëse madje edhe kundër një sulmi që nuk është kërcënues për jetën, përderisa nuk ka asnjë mundësi të tjera të mbrojtjes në dispozicion.

Megjithatë, siç kemi shtjelluar më lart, në çështjen konkrete nuk është gjetur asnjë provë se ka pasur sulm prezent apo të atëçastshëm. Perceptimi i gabuar i përmendur në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar të Gjykatës Supreme dhe në arsyetimin e aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut nuk ka ndikuar në korrektësinë e dispozitivit.

Aktgjykimi i kundërshtuar i ka cilësuar në mënyrë të qartë elementet e veprave penale të kryera nga i pandehuri. Gjykata Supreme gjen se pretendimi i mbrojtjes së i pandehurit ka vepruar në tejkalim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme është jo merit. Edhe për



institucionin e tejkalimit të kufijve të mbrojtjes së nevojshme, të gjitha elementet që kërkohen me nenin 8 paragrafin 2 të KPK-së për mbrojtjen e nevojshme duhet të paraqesin një sulm të kundërligjshëm, real dhe të atëçastshëm ndaj një vlere ose të drejte të mbrojtur me ligj dh enjë vepër me qëllim të zmbropsjes së atij sulmi. Mungon vetëm elementi i proporcionalitetit të veprës me shkallën e rrezikut që paraqet sulmi. Tanimë është vetëtuar më lart se instancat e mëparshme kanë konstatuar saktë mungesën e sulmit të atëçastshëm në momentin e të shtënave.

4. Vendimi mbi sanksionet penale

Kolegji gjen se mendimi i të pandehurit se dënimi i shqiptuar është i papërshtatshëm dhe drakonian dhe se prandaj duhet të ulet në masë të madhe, është i pabazë. Aktgjykimi i kundërshtuar e ka caktuar dënimin saktë dhe pa gabime ligjore, në përputhje me nenin 64 paragrafin 1 të KPK-së.

Pas ankesave të paraqitura nga prokuroria dhe pala e dëmtuar Gjykata e Apelit bëri një rivlerësim të sanksioneve penale. Është vërtetuar se gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur t'i vlerësojë dhe t'i peshojë të gjitha rrethanat relevante lehtësuese dhe rënduese.

Korniza e dënimit e përcaktuar me dispozitën e nenit 147 pikën 11 të KPK-së shtrihet prej dënimit me 10 vjet burgim deri te burgimi afatgjatë, i cili në përputhje me nenin 37 paragrafin 2 të KPK-së, si dënim i ndarë, shtrihet prej burgimit me njëzetënjë (21) deri në dyzet (40) vjet. Duke i marrë parasysh rrethanat lehtësuese të vërtetuara nga gjykata e shkallës së parë: moshën e vjetër të të pandehurit (63 vjeç në kohën e kryerjes së veprave penale) dhe faktin se ka shfaqur pikëllim për vdekjen e dy viktimave dhe në anën tjetër rrethanat rënduese: rrezikun e lartë për jetën e qenieve të tjera njerëzore, faktin se fëmijët e viktimave i ka bërë jetimë, mënyrën mizore të kryerjes së veprës penale dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, Gjykata Supreme arriti deri te dënimi me njëzetepesë (25) vjet burgim afatgjatë – një sanksion pothuajse në mes të dënimit minimal prej dhjetë (10) vitesh burgim dhe maksimumit prej dyzet (40) vitesh burgim afatgjatë.

Sa i përket kryerjes së veprës së dytë, mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në përputhje me nenin 328 paragrafin 2 të KPK-së, aktgjykimi i kundërshtuar saktë ka marrë parasysh pranimin e fajësisë së të pandehurit dhe saktë ka arritur deri te dënimi në limitin e ulët të kornizës të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 328 paragrafit 2 të KPK-së për dënimin me burgim me një (1) vit.

Në përputhje me rregullat e përcaktuara me nenin 71 paragrafin 2 nën-paragrafin 1 të KPK-së, Gjykata e Apelit pa gabime ligjore ka unifikuar dënimet për të dy veprat penale në një dënim me njëzetepesë (25) vjet burgim afatgjatë.

5. Konstatimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

Rrjedhimisht, për arsyet e sipërpërmendura Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur si në dispozitiv, në përputhje me nenin 430 paragrafin 2 lidhur me nenin 420 paragrafin 1, pikën 2, dhe nenin 423 të KPPK-së.

Kryetar i kolegjit:

Procesmbajtës

Tore Thomassen
Gjyqtar i EULEX-it

Holger Engelmann
Zyrtar ligjor i EULEX

Gjykata Supreme e Kosovës

API-KZL-№ 92/2011

Republika Kosovo



Prishtinë

25 maj 2011

SAKTESINË E KOPJËS E VËRTETON
IACNOSTI OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtor i autorizuar
President (L. D. N. K.)